



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

NR. 17, Datë 10/03/2021

**“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z.LUIGI SORECA”**

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z. Luigi Soreca si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën \_\_\_\_\_. 2022, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, për dhënie titulli "Qytetar Nderi" Z.LUIGI SORECA si dhe mbështetur në relacionin e Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e titullit “Qytetar Nderi” me motivacionin:

**“Mik i shtrenjtë i Gjirokastrës dhe Shqipërisë, i cili me përkushtim, dashuri e angazhim konkret, frymëzoi, ideoi e mbështeti projekte europiane që promovojnë zhvillimin e turizmit, kulturës dhe shoqërisë civile”.**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Laydi Hasani

